

**U.F.O UNIVERSITY**  
**FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQERORE**  
**DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISE SE PERGJITHSHME**

**DIPLOMA E NIVELIT TE DYTE (DND)**

**NË**

**PSIKOLOGJI KLINIKE**



## **Hyrje**

U.F.O University është një institucion universitar jo publik, i pavarur dhe laik i Arsimit të Lartë Shqiptar që shquhet si një institucion edukacional bashkëkohor dhe standarte akademike.

Liçensuar në 10 Prill të vitit 2004 me Vendim nr. 197 të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe plotësuar me vendimet nr. 5663/1 të datës 1 Shtator 2005 dhe nr. 8981 datë 27 Dhjetor 2005 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, U.F.O University hapi dyert në vitin akademik 2004-2005.

Nga momenti i themelimit në 2004, U.F.O University krijoi një sistem përgatitjeje profesionale në disa fusha dhe sot formon gjeneratën e re të intelektualëve shqiptarë në tetë programet e studimit të studimit universitar: Shkenca Politiko – Administrative, Shkenca Juridike, Shkenca Komunikimi, Psikologji, Financë – Bankë, Arkitekturë, Stomatologji dhe Farmaci.

Fakultetet dhe Departamentet përdorin programe mësimore fleksibile, të adaptueshme dhe të përputhshme me kërkesat formuese europiane dhe Kartën e Bolonjës, konform legjislacionit në fuqi, vendimeve të këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.

Në vitin akademik 2008 – 2009, vetëm në ciklin e parë të studimit universitar ndjekin studimet mbi 4000 studentë. Formimi akademik dhe përgatitja profesionale e tyre realizohet nga 360 pedagogë: 57 me titullin Profesor Doktor, 41 Doktorë Shkencash të ndihmuar nga një kontigjent cilësor asistentë pedagogësh me Master, Specializime apo kualifikime pasuniversitare.

U.F.O University me këtë nisëm kaq të rëndësishme mbështet plotësisht rëndësinë e profilit psikologjik në shoqërinë Shqiptare dhe ofron një studim më të thelluar dhe bashkëkohor për këtë shkencë.

## **Profili i studentit në përfundim të programit të studimit të Ciklit të dytë**



Psikologjia klinike është një nga disiplinat më të zhvilluara dhe më popullore sot në fushën e psikologjisë për sa kohë ajo meret me trajtimin e individëve dhe grupeve të njerëzve me probleme psikologjike, ashtu si dhe diagnostikimin apo parandalimin e këtyre problemeve. Që nga viti 1896 kur Zigmund Freud praktikoi për herë të parë psikologjinë klinike, kjo fushë e psikologjisë evoluoi me shpejtësi. Në ditët e sotme ekzistojnë rreth 200 orientime teorike të psikologjisë ndër të cilat studentët mund të zgjedhin të specializohen akoma më tej për një trajtim më cilësor të klientëve të tyre. Diploma e Nivelit të Dytë në Psikologji Klinike pranë U.F.O University synon të jetë elitare në fushën akademike shqiptare, sepse është konceptuar tu ofrojë studentëve jo vetëm informacionin më të fundit teorik, por edhe aspektin praktik të bazuar në kërkimin shkencor bashkëkohor.

Ky program i Diplomës së Nivelit të Dytë në Psikologji Klinike është konceptuar mbi bazën e një objektivi madhor:

**Të kualifikojë dhe të trajtojë nga ana teorike dhe praktike psikologë të fushës së përgjithshme, apo specialistë të fushave të tjera sociale si punonjës sociale, etj., në lidhje me problemet e:**

- Vlerësimin psikologjik
- Konceptimin të diagnozës mendore
- Planifikimin dhe implementimin të ndërhyrjes psikologjike
- Vlerësimin të ndërhyrjes
- Mënyrën së komunikimit me klientin
- Kërkimin shkencor në fushën e Psikologjisë Klinike


Një ndër avantazhet akademike të këtij programi studimi është harmonizimi i teorisë dhe praktikës në katër nivele pune:

- *Punë direkte me klientin*
- *Punë indirekte (analiza e eksperiencave të specialistëve të tjerë)*
- *Vëzhgimin e rasteve në klinika spitalore të shëndetit mendor*
- *Puna në organizata të shëndetit mendor*

Diploma e Nivelit të Dytë në Psikologji Klinike në U.F.O University, synon të krijojë një profil akademik të studentit të diplomuar i cili do të jetë në gjendje të:

- *zotërojë aftësitë akademike dhe praktike bashkëkohore në fushën e psikologjisë klinike për të ndërtuar një model ndërhyrjeje terapeutike që të përputhet me kulturën shqiptare.*
- *përdorë në mënyrë të suksesshme modelin e terapive konstruktive për trajtimin e rasteve të psikozave dhe neurozave.*
- *pajisen me aftësi të veçanta të kërkimit shkencor cilësor dhe sasior për të kuptuar, njohur dhe analizuar rastet klinike në Shqipëri.*
- *përdorin aftësitë akademike dhe praktike profesionale për të analizuar dhe përdorur më tej eksperimentat e mbledhura gjatë trajtimit të rasteve.*
- *punojnë në grup me profesionistët e fushës së psikologjisë klinike për të vazhduar më tej trajnimin e tyre profesional mbi praktikat dhe aftësitë që posedojnë profesionistët e kësaj disipline.*

## **Njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë profilin**



Diploma e Nivelit të Dytë në Psikologji Klinike përmban njohuritë akademike teorike dhe praktike më bashkëkohore në fushën e psikologjisë klinike. Këto njohuri do të shërbejnë studentëve të forcojnë më tepër sensin praktik të punës me klientët e tyre. Studentët, në fund të programit, do të jenë të aftë të ndërmarrin kërkime shkencore në fushën e psikologjisë klinike, të vlefshme për specifikën shqiptare dhe profesionistët e kësaj fushe në Shqipëri.

Njohuritë akademike që ofron ky program studimi, synojnë të krijojnë modelin e të menduarit kritik të studentët, në lidhje me rastet teorike dhe praktike të psikologjisë sociale. Në veçanti, ky model i të menduarit kritik, synon të hulumtojë lidhjen që ekziston mes problemeve psikologjike dhe ambjentit social.

Kompetenca e profilit të Diplomës së Nivelit të Dytë në psikologji klinike, do të jetë dhe aftësia për të lidhur teorinë me praktikën, duke marrë në analizë rastet praktike dhe, duke i veshur ato me boshtin teorik në psikologji klinike. Do të

ofrohen mënyra të reja të mendimit rreth hartimit të planit dhe implementimit të ndërhyrjes terapeutike, bazuar në tendencat më të fundit bashkëkohore.

Njohuritë bazë që karakterizojnë këtë program studimi të nivelit të dytë, do të lidhen me aftësitë që duhet të demonstrojë një profesionist i psikologjisë klinike, në mënyrën se si e koncepton problemin psikologjik, si e kryen vlerësimin dhe ndërhyrjen psikologjike.

Diploma e Nivelit të Dytë në Psikologjinë Klinike, krijon modelin e ri bashkëkohor në Shqipëri se: profesionistët e psikologjisë klinike, duhet të jenë të aftë të përshtasin zhvillimin e tyre individuale profesional, me specifikën e ambjentit shqiptar dhe zbatimin me rigorozitet të kodit të psikologut në Shqipëri.

## **Mundësitë e punësimit**

Studentët që mbarojnë Programin e Studimit të Nivelit të Dytë në Psikologji Klinike pranë U.F.O University mund të punojnë si psikologë klinikistë në:

- qendrat spitalore universitare
- agjenci shtetërore dhe joqeveritare të shëndetit mendor
- qendra të rehabilitimit fizik dhe mendor
- qendra të këshillimit universitar
- në burgje dhe institucione riedukimi
- gjykata dhe rajone policie
- individualisht në sektorin privat (studio psikologjike legale)

# Kurrikula

## VITI I PARE, SEMESTRI I PARE

Nr.	Lënda	Tipi i veprimtarisë	Kredite
1	Psikologji Klinike	E SPECIALITETIT	6
2	Vlerësim Psikologjik	E SPECIALITETIT	7
3	Metodat e Kërkimit në Psikologji 1	E SPECIALITETIT	5
4	Psikopatologji	E SPECIALITETIT	6
5	Psikologji Zhvillimi e Avancuar	E PËRGJITHSHME	6
TOTALI			30

## VITI I PARË, SEMESTRI I DYTE

Nr.	Lënda	Tipi i veprimtarisë	Kredite
1	Aftësitë Praktike në Psikologji	E SPECIALITETIT	7
2	Psikoterapi	E SPECIALITETIT	8
3	Psikologji Sociale e Avancuar	E PËRGJITHSHME	5

## LËNDË ME ZGJEDHJE

Nr.	Lënda	Tipi i veprimtarisë	Kredite
1	Praktikë në Vlerësim Psikologjik	E PERGJITHSHME	4
2	Aspekte teorike të ndërhyrjes në psikologji klinike	E PERGJITHSHME	4
3	Terapia familjare	E SPECIALITETIT	4
TOTALI			30

## VITI I DYTË, SEMESTRI I PARË

Nr.	Lenda	Tipi i veprimtarise	Kredite
1	Psikofarmakologji	E SPECIALITETIT	6
2	Praktika		20

## LËNDË ME ZGJEDHJE

Nr.	Lenda	Tipi i veprimtarise	Kredite
1	Etika profesionale psikologjike	E PERGJITHSHME	4
2	Konceptimi dhe analiza e rasteve klinike	E SPECIALITETIT	4
3	Trauma dhe ndërhyrja në raste krizash	E SPECIALITETIT	4
TOTALI			30

## VITI I DYTË, SEMESTRI I DYTË

Nr.	Lenda	Tipi i veprimtarise	Kredite
1	Terapia në grup	E SPECIALITETIT	5
2	Diploma		25
TOTALI			30

## **INFORMACIONE TE PERGJITHSHME**

- **Kohëzgjatja: 2 vjet**
- **Kredite: 120**
- **Full-time (pasdite)**
- **Frekuentimi: i detyrueshem (75% e leksioneve dhe seminareve)**

### **A. Kriteret e pranimit**

1. Vlerësimi i dosjes personale te kandidatit
2. Dëshmi e gjuhës së huaj (anglisht)

### **B. Dokumentat e nevojshme**

1. Kërkesë pranimi – formular tip (së bashku me 4 fotografi me ngjyra tip pashaportë)
2. Çertifikatë lindje
3. Diplomë universitare e ciklit të parë (3vjeçare) (kopje e legalizuar) /listë notash
4. Çertifikatë e gjuhës angleze
5. Vërtetim pune (nëse disponon)
6. Curriculum vitae

### **C. Periudha e Aplikimit dhe Rregjistrimit**

- Aplikimi dhe Rregjistrimi: **17 nëntor – 15 dhjetor**

### **D. Çmimi dhe forma e pagesës**

Taksa shkollore vjetore: **2000 Euro**

**E. Kontakti (adresa e departamentit, nr. tel, fax dhe emaili zyrtar).**

<b>MENYRA E KONTAKTIT</b>	<b>TE DHENAT</b>
<b>1. Adresa e Departamentit</b>	<b>Bulevardi Zogu i Pare (ish pallati i kulturës “Ali Kelmendi”)</b>
<b>2. Nr. telefoni Fax.</b>	<b>042 2 22 71 601 / 042 2 22 71 602 042 2 22 66 374</b>
<b>3. E – mail Web site</b>	<b>ciklidyte@gmail.com <a href="http://www.ufouniversity.al">www.ufouniversity.al</a></b>

# U.F.O UNIVERSITY

Universitas - Fabrecata - Optime

## DIPLOMA E NIVELIT TE DYTE

### DEPARTAMENTI I SHKENCAVE TE KOMUNIKIMIT - GAZETARI -


**Misioni, objektivat formuese të programit të studimit të Ciklit të Dytë.**

Informimi masiv dhe tërë industria mediatike dhe komunikative në shërbim të tij vijnë me një rëndësi dhe interes të posaçëm, si një fenomen i shekullit të XXI-të i përmasave bashkëkohore, në kushtet kur është formuar sistemi global i komunikimit dhe kur miliona, ndonjëherë dhe miliarda njerëz në të gjithë rruzullin tokësor, mësojnë për ngjarjet në momentin kur ato ndodhin dhe marrin komentet për këto ngjarje. Për këtë arsye, formimi i specialistit në këtë fushë, si një personalitet harmonik krijues e ndërveprues, kërkon një sistem edukimi kompleks dhe sa më origjinal, kërkon rrjedhshmëri, integritet, si dhe përpjekjet e një stafi të madh profesorësh, të cilët i përkasin jo vetëm fushës së shkencave të komunikimit, të gazetarisë, por dhe të specialitetve të ndryshme dhe që punojnë sipas një plani të njëjtë mësimor. Në këtë frymë vlerësimi dhe bashkëpunimi dhe propozohet programi i mëposhtëm, i cili synon:

- 1) të krijojë mundësitë e integritit praktik dhe teorik të studentëve në industrinë sociale dhe organizative të shkencave të komunikimit dhe si dhe të komunikimit masiv, përmes operimit nëpërmjet informacionit në një nivel akademik.
- 2) të orientojë studentët në fushën e kërkimeve studimore në fushën e komunikimit masiv, të mediave si dhe sa i përket planifikimit të politikave, hartimit dhe zbatimit të tyre në ato aspekte që kërkojnë dhe kanë si element të rëndësishëm bashkëpunimin me profesionistë të aftë në fushën e komunikimit masiv.
- 3) të mundëojë për studentin njohuritë për zhvillimin bashkëkohor të teorive të komunikimit dhe medias.
- 4) të mundësojë për studentin njohuritë në komunikimin menaxherial, përmes studimit të këtyre elementëve në kinematografi, shtypin e shkruar, radio dhe televizion, dhe në përgjithësi në media, shoqëria dhe politikë.
- 5) të japë të dhënat bazë të metodologjisë kërkimore në fushën e mediave dhe variante të tyre të aplikimit në situata të ndryshme, në raport me elementët më të fortë dhe të dobët të veprimit.

- 6) të aftësojë studentin në përfitim e teknikave individuale në komunikim dhe në media, si dhe variante të qarta të hartuara në mënyrë të pavarur për aplikimin në situata të ndryshme.
- 7) të aftësojë studentin në përfitim e teknikave analizuuese dhe kërkimore në fushën e komunikimit masiv dhe të mediave.
- 8) të aftësojë studentin për hartimin e planin e veprimit kërkimor në fushën e komunikimit dhe të mediave, si dhe variante të aplikimit të tij në situata të ndryshme.

**DNP në Shkenca**  
**Kounikimi**



**Diplome e Nivelit te Dyte (DND) ne "Gazetari" me profile**

- Marrëdhënie me Publikun dhe Marketing
- Drejtim dhe Manaxhim i Mediave
- Gazetari Nderkombetare

### **A - Profili i studentit në përfundim të programit të Ciklit të Dytë**

- 1) të inicojë, hartojë dhe të zhvillojë një kërkim të kualifikuar në fushën e komunikimit dhe në media.
- 2) të krijojë produkte mediatike, të cilat të jenë konform standardeve ndërkombëtare.
- 3) të punojë në grupe kërkimore të fushës së komunikimit dhe të mediave, të fushave të tjera që lidhen ngushtë me to, në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.
- 4) të propozojë teza kërkimore në fushën e komunikimit dhe të mediave.

Stafi pedagogjik me anë të hartimit të këtij programi dhe në përfundim të këtij kursi synon të rrënjosë tek studenti dëshirën:

- 1) Për të konsideruar, dhe përmirësuar argumentet dhe përfundimet e tij parë në këndvështrimin e rezultateve empirike, apo dhe të kundër argumenteve.

- 2) Të ndajë dhe të diskutojë argumentet e kërkimit, gjetjet dhe përfundimet, duke përfshirë këtu edhe raportet për vlerësimin e tyre.
- 3) Të kontribuojë me korrektësi, ndershmëri dhe profesionalizëm në aspektin praktik, teorik dhe atë kërkimor në fushën e komunikimit dhe të mediave në Shqipëri.

## **B- Njohuritë dhe kompetencat që karakterizojnë profilin**

Programi i Nivelit të Dytë në “Gazetari” përfaqëson një mekanizëm akademik të argumentuar, të profilizuar dhe të detajuar për formimin e studentëve me kapacitete të spikatura në fushën e komunikimit masiv dhe të mediave në planin praktik, po ashtu dhe në atë hulumtes e kërkimor në përgjigje dhe në raportin e duhur me kërkesat bashkëkohore dhe sfidat me të cilat përballet kjo disiplinë në vendin tonë, po ashtu edhe në raport me standardet e duhura dhe operative ndërkombëtare. Në këtë kontekst, vlerësojmë se programi prezantohet me nivelin e duhur akademik, metodik dhe laboratorik për t’i mundësuar studentëve informacionin më bashkëkohor, njohuritë më të fundit dhe risitë profesionale që vijnë në zhvillim në fushën e shkencave të komunikimit dhe të medias, duke patur parasysh faktin e konsolidimit të këtyre të fundit në sistemet politike dhe shoqërore si “pushteti i katërt” dhe si një hallkë në zinxhirin funksional organizativ institucional.

- 1) të kanalizojë tek studenti praktikimin e njohurive në një aspekt sa më pranë interesit të tij akademik dhe praktik në fushën e shkencave të komunikimit dhe të medias, edhe përmes konsolidimit të një përfytyrimi sa më objektiv dhe të saktë për thelbin e dukurisë.
- 2) të shtjellojë sistemin e koncepteve dhe termave, si dhe të detajojë principet dhe parimet lidhur me objektin e studimit dhe risinë degëzimeve që profili përfton në praktikë.
- 3) të arrijë aftësimin e studentëve për të konsoliduar njohuritë e tyre për profilin e përzgjedhur përmes studimit të pavarur, analizës origjinale dhe individuale, që sjell dhe daljen në konkluzione të pavarura akademike prej tyre, të cilat finalizohen me përpjekjet e vetë studentit edhe në bashkëpunim me stafin pedagogjik për t’i transmetuar më pas praktikisht;
- 4) të mundësojë aftësimin e studentëve për të hyrë në bashkëpunimin dhe bashkëveprim praktik dhe akademik me homologë/kolegë, por edhe të përdorin në mënyrë të pavarur me sistem analitik dhe argumentues informacionin që rrjedh nga disiplinat e cikleve social-ekonomike dhe historiko-shoqërore.

Për arritjen e këtyre qëllimeve, programi është profilizuar në tri drejtime kryesore - “Marrëdhënie me publikun dhe Marketing”, 2- “Drejtim dhe Menaxhim i Mediave”, 3- “Gazetaria Ndërkombëtare”.

## **C. Plani mësimor për profilin “Marrëdhëniet me publikun dhe marketing”** **Kohëzgjatja 2 vjet - 120 kredite**

### ***Viti I***

### ***Semestri I***

1. Teoria e Komunikimit Masiv.
2. Mjetet e komunikimit masiv: probleme të organizimit dhe produktivitetit.
3. PR politik
4. Histori e Shtypit Shqiptar
5. Antropologji.

### ***Semestri II***

1. Teoria dhe praktika e marrëdhënieve me publikun.
2. Konsultimet për marrëdhëniet me publikun.
3. Marketingu informativ.
4. Filozofi.
5. Psikologji
6. Redaktimi letrar dhe publicistik/ Bazat e teorisë dhe praktikës së përkthimit

### ***Viti II***

#### ***Semestri I***

1. Etika në Media dhe Komunikimi Masiv.
2. E drejta dhe administrimi i Mass-Mediave
3. Menaxhimi në Mass-Media.
4. Historia e shtypit Botëror.
5. Përpunimi informatik i të dhënave me SPSS/Modelimi i web-site-ve.

#### ***Semestri II***

1. Stazh / Praktikë profesionale - Prodhimi i një produkti mediatik.
2. Tezë diplome - Principet metodologjike për shkrimin e dizertacionit. Procesi i shkrimit të dizertacionit.

***Plani mësimor për profilin “Drejtim dhe Menaxhim i Mediave”.***  
***Kohëzgjatja 2 vjet - 120 kredite***

### ***Viti I***

#### ***Semestri I***

1. Teoria e Komunikimit Masiv.
2. Mjetet e komunikimit masiv: probleme të organizimit dhe produktivitetit.
3. Psikologjia e administrimit të mediave.
4. Histori e Shtypit Shqiptar.
5. Antropologji.

## ***Viti I***

### ***Semestri II***

1. Teoria dhe praktika e marrëdhënieve me publikun.
2. Planifikimi në media.
3. Marketingu informativ.
4. Teoria e administrimit
5. Organizmi dhe teknologjia e produkteve të radios dhe televizionit.
6. Redaktimi letrar dhe publicistik/Bazat e teorisë dhe praktikës së përkthimit

## ***Viti II***

### ***Semestri I***

1. Etika në Media dhe Komunikimi Masiv.
2. Sistemi i administrimit shtetëror dhe municipal.
3. Menaxhimi në Mass-Media.
4. Historia e Shtypit Botëror
5. Përpunimi informatik i të dhënave me SPSS /Modelimi i web-site-ve.

### ***Semestri II***

1. Stazh / Praktikë profesionale - Prodhimi i një produkti mediatik.
2. Tezë diplome - Principet metodologjike për shkrimin e dizertacionit. Procesi i shkrimit të dizertacionit.

**Plani mësimor për profilin “Gazetaria Ndërkombëtare”.**  
***Kohëzgjatja 2 vjet - 120 kredite***

## ***Viti I***

### ***Semestri I***

1. Teoria e Komunikimit Masiv.
2. Mjetet e komunikimit masiv: probleme të organizimit dhe produktivitetit.
3. Politika e jashtme dhe gazetaria ndërkombëtare.
4. Histori e Shtypit Shqiptar
5. Antropologji

### ***Semestri II***

1. Teoria dhe praktika e marrëdhënieve me publikun.
2. Planifikimi në media.

3. Gjeopolitika
4. Marrëdhëniet ndërkombëtare: zhvillimet e dukurisë dhe përcaktimi i teorisë
5. Shteti në kushtet e globalizimit.
6. Redaktimi letrar dhe publicistik/Bazat e teorisë dhe praktikës së përkthimit.

## ***Viti II***

### ***Semestri I***

1. Etika në Media dhe Komunikimi Masiv.
2. Multikulturalizmi: diskursi dhe realiteti politik.
3. Bazat e teorisë së publicistikës.
4. Historia e Shtypit Botëror.
5. Fotografetaria/Modelimi i web-site-ve

### ***Semestri II***

1. Stazh / Praktikë profesionale - Prodhimi i një produkti mediatik.
2. Tezë diplome - Principet metodologjike për shkrimin e dizertacionit. Procesi i shkrimit të dizertacionit.

### **D. Mundësitë për punësim**

Plani Mësimor i Diplomës së Nivelit të Dytë synon të integrojë kurse, të cilat nxisin aftësitë metodologjike individuale, përmes stimulimit të studimit të pavarur, ose në grup të studentëve dhe bashkëpunimit me struktura mbështetëse të aftësisve të tyre teorike dhe praktike në lëmin e gazetarisë. Në përfundim të këtij programi studimi dyvjeçar studentët do të jenë të kualifikuar majftueshëm për të ushtruar me mjeshtëri profesionin e tyre në disa prej aspekteve kyçe të fushës së shkencave të komunikimit dhe medias, po ashtu dhe për të zhvilluar një aktivitet studimor të pavarur. Në përfundim të këtij programi studimi të nivelit të dytë, studentët janë të aftë të synojnë mundësi punësimi në:

- 1) kompani të kualifikuara mediatike
- 2) departamente shtetërore
- 3) korporata mediatike
- 4) agjenci mediatike dhe agjenci reklamash
- 5) institucione politike
- 6) përfaqësimin e amasadave të huaja brenda vendit dhe jashtë tij (Departamenti i Informacionit dhe PR-it)
- 7) Ministri dhe Agjenci shtetërore të Lajmeve dhe të Marrëdhënieve me Publikun.

Ky program është një start optimal dhe një mundësi reale për vijimin e studimeve për doktoraturën.

### **Kritere dhe dokumente të pranimit**

1. Kërkesë pranimi e plotësuar nga aplikanti, dhe katër fotografi me përmasat e pasaportës.
2. Curriculum Vitae
3. Diplomë universitare dhe liste notash e legalizuar
4. Çertifikatë lindje
5. Vërtetim i vendit të punës (nëse disponohet)
6. Çertifikatë/Dëshmi e gjuhëve të huaja (preferenciale)
7. Çertifikatë/Dëshmi për njohuritë kompjuterike (preferenciale)

### **Periudha e aplikimit dhe e Rregjistrimit**

-Aplikimi dhe Regjistrimi: 17 nëntor - 15 dhjetor

### **Cmimi dhe forma e pageses**

Taksa shkollore vjetore: 2000 Euro

Për informacione të mëtejshme kontaktoni:

Departamenti i Shkencave të Komunikimit

Bulevardi “Zog i Parë” (Pas Muzeut Historik Kombëtar, Godina e ish-Estradës së Tiranës)

Tel: 04 2 22 71 602/ 04 2 22 71 601

Fax: 04 2 22 66 374

Email: [ciklidyte@gmail.com](mailto:ciklidyte@gmail.com)

Web site - [www.ufouniversity.al](http://www.ufouniversity.al)

**U** NIVERSITAS **F** ABREFACTA **O** PTIME


**FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE**  
**DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKO-**  
**ADMINISTRATIVE**

---


**STUDIME**  
**PASUNIVERSITARE**  
**Master I, II & Diploma të Nivelit të Dytë**


1. **ADMINISTRIM PUBLIK**
2. **PUSHTET EKZEKUTIV**
3. **HAPSIRA PUBLIKE EUROPIANE**
4. **QEVERISJE LOKALE**
5. **POLITIKA DHE MENAXHIM SHËNDETSOR**
  
6. **MARËDHËNIE NDËRKOMBËTARE**
7. **STUDIME MBI SIGURINË**
8. **INTEGRIM EUROPIAN**
9. **STUDIME BALLKANIKE**
10. **POLITIKA E JASHTME DHE DIPLOMACIA**

**OFERTA U.F.O për vitin akademik 2008-  
2009**

 **PROGRAM AKADEMIK që i**  
**përgjigjet NEVOJAVE KOMBËTARE për**  
**INTEGRIM EUROPIAN të**  
**FUNKSIONARËVE PUBLIKË**

 **FORMIM BAZË dhe i  
SPECIALIZUAR në përputhje me STATUSIN  
E NËPUNËSIT CIVIL dhe FUNKSIONARIT  
PUBLIK EUROPIAN**

 **STIMULIMI I KARRIERËS,  
RIKONVERTIM PROFESIONAL, SIGURI e  
vëndit të PUNËS**

 **PROGRAME CILËSORE, PAGESË E  
ULËT (subvencionuar), FLEKSIBILITET  
KOHOR**

**U** niversitas **F** abrefacta **O** ptime

## **NJË UNIVERSITET PERËNDIMOR**

---

- Universiteti "U.F.O" - është një institucion universitar jo publik, i pavarur dhe laik i Arsimit të Lartë Shqiptar që shquhet si një institucion edukacional bashkëkohor me standarte akademike.
- Liçensuar në 10 Prill të vitit 2004 me Vendim nr.197 të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe plotësuar me vendimet nr. 5663/1 të datës 1 Shtator 2005 dhe nr. 8981 datë 27 Dhjetor 2005 të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës, Universiteti U.F.O hapi dyert në vitin akademik 2004-2005.
- Nga momenti i themelimit në 2004, U.F.O University krijoi një sistem përgatitjeje profesionale në disa fusha dhe sot formon gjeneratën e re të intelektualëve shqiptarë në tetë degë të studimit universitar: **Shkenca Politiko-Administrative, Shkenca Juridike, Shkenca Komunikimi, Psikologji, Financë-Bankë, Arkitekturë, Stomatologji dhe Farmaci.**

- Fakultetet dhe Departamentet përdorin programe mësimore fleksibile, të adaptueshme dhe të përputhshme me kërkesat formuese europiane dhe Kartën e Bolonjës, konform legjislacionit në fuqi, vendimeve të Këshillit të Ministrave dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës.
- Në vitin akademik **2008-2009**, vetëm në ciklin e parë të studimit universitar ndjekin studimet mbi **4000** studentë. Formimi akademik dhe përgatitja profesionale e tyre realizohet nga **360** pedagogë: **57** me titullin **Profesor Doktor**, **41** **Doktorë Shkencash** të ndihmuar nga një kontigjent cilësor asistentë pedagogësh me Master, Specializime apo kualifikime pasuniversitare.
- Universiteti U.F.O kontribuon në krijimin e burimeve njerzore me ekspertizë të specializuar dhe për sektorin publik, për administrimin e proceseve ekonomike, sociale dhe politike në sinkron me strategjitë kombëtare të integritimit dhe standarteve euroatlantike.

---

## **FAKULTETI I SHKENCAVE SHOQËRORE**

### **DEPARTAMENTI I SHKENCAVE POLITIKO-ADMINISTRATIVE**

---

- **Misioni i U.F.O University: formimi bashkëkohor i elitave universitare dhe profesionale.**

**Misioni i programit:**

**“Formimi dhe modernizimi Administratës Shtetërore”**

- Përkushtimi akademik dhe institucional i Universitetit tonë, në funksion të transformimit perëndimor vëndit, na shtyn të kontribuojmë në modernizimin e strukturave shtetërore nëpërmjet investimit tek kapitali human.
- Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative i U.F.O University lanson një program të plotë dhe kompleks për Ciklin e Dytë dhe të Tretë në Administrim Publik dhe Marëdhënie Ndërkombëtare.

## **Ekspertizë të specializuar në fushat fundamentale për formimin e funksionarëve publikë**

- Kurikulë universitare që harmonizon paketa disiplinash: shkenca juridike, socio-politike, ekonomike, marëdhënie ndërkombëtare, antropologjike, historike, komunikimi dhe menaxhimi publik.
- Staf akademik i përbërë nga pedagogë me tituj dhe grada shkencore, me përgatitje teorike dhe eksperiencë të specializuar
- Forma arsimimi fleksibile (Ndjekja e leksioneve dhe seminareve mund të bëhet sipas zgjedhjes gjatë javës nga ora 17.00 - 20.30 ose në fundjavë nga ora 8.00 - 15.30)

## **Sistem tërësor, kompleks dhe i specializuar në sferën e Administratës Publike dhe Marëdhënieve Ndërkombëtare**

### **Master i Nivelit të Parë (MN I):**

(1 vit, 60 kredite)

- **Qeverisje dhe Administrim Publik** (frekuentim mbasdite ose në fundjavë)
- **Diplomaci dhe Marëdhënie Ndërkombëtare** (frekuentim mbasdite ose në fundjavë)

### **Diploma të Nivelit të Dytë (DND) në:**

(2 vjet, 120 kredite)

- **Administrim Publik dhe Pushtet Ekzekutiv** (frekuentim mbasdite ose në fundjavë)
- **Administrim Publik dhe Qeverisje Vendore** (frekuentim mbasdite ose në fundjavë)
- **Administrim Publik dhe Hapsira Publike Europiane** (frekuentim mbasdite ose në fundjavë)
- **Administrim Publik dhe Politika e Menaxhim Shëndetsor** (frekuentim mbasdite ose në fundjavë)
- **Marëdhënie Ndërkombëtare dhe Integrim European** (frekuentim mbasdite ose në fundjavë)
- **Marëdhënie Ndërkombëtare dhe Politika e Jashtme e Diplomacia** (frekuentim mbasdite ose në fundjavë)
- **Marëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime Ballkanike** (frekuentim mbasdite ose në fundjavë)
- **Marëdhënie Ndërkombëtare dhe Studime mbi Sigurinë** (frekuentim mbasdite ose në fundjavë)

### **Master i Nivelit të Dytë (MN II):**

(1 vit, 60 kredite)

---

- **Shkenca Administrative** (frekuentim mbasdite ose në fundjavë)
- **Pushtet ekzekutiv** (frekuentim mbasdite ose në fundjavë)
- **Qeverisje lokale** (frekuentim mbasdite ose në fundjavë)
  
- **Politikë e Jashtme dhe Diplomaci** (frekuentim mbasdite ose në fundjavë)
- **Maredhenie Ndërkombëtare** (frekuentim mbasdite ose në fundjavë)

## **Kushte optimale për formim bazë, zhvillim të karrierës apo konvertim profesional**

---

- Hapsira mësimore, studimore dhe konferencash në Qëndër të Tiranës (Fakulteti i Shkencave Shoqërore të U.F.O University ndodhet mbas Muzeumit Kombëtar).
  - Sallë multimedia (rrjet kompjuterik me lidhje permanente interneti falas për studentët)
  - Bibliotekë (me mijra tituj dhe revista specialiteti).
-

# OFERTA EDUKACIONALE NË SHKENCA ADMINISTRATIVE

## Misioni, objektivat e formimit dhe koncepti organizues i programit:

- **Formimi bashkëkohor i funksionarëve publikë dhe modernizimi i administratës shtetërore**
- Programi eliminon përgatitjen e specialistëve me kompetencë të kufizuar, zgjeron hapsirën e specializimit, tejkalon kufijtë tradicionalë midis shkencave duke afruar një trajtim ndërdisiplinor dhe multishkencor: Shkenca Politike, Shkenca Administrative, Shkenca Juridike, Shkenca Ekonomike, Marëdhënie Ndërkombëtare, Shkenca Komunikimi etj.
- Programet: Master i Nivelit të Parë, Diploma të Nivelit të Dytë, Master i Nivelit të Dytë në Administrim Publik ju adresohen të diplomuarve të Arsimit të Lartë të interesuar të thellojnë formimin profesional në administrim publik, sisteme qeverisëse, politika dhe menaxhim sektorial, qeverisje vendore, zhvillim institucional, integrim europian etj.
- Koncepti i organizimit: strukturë me sistem modular:
  - ✚ prezantimi dhe asimilimi i koncepteve fundamentale për sferën shkencore dhe akademike të administrimit publik;
  - ✚ përshkrimi i temave/subjekteve kryesore të specialitetit;
  - ✚ ofrimi i paketave opsionale, superspecializuese;
  - ✚ zhvillimi i kapaciteteve/aftësive të studentëve, për të përdorur instrumentet dhe potencialin intelektual të përfutur në analiza personale dhe kolektive mbi fenomenet dhe proceset në sektorin publik dhe atë privat, në plan teorik dhe praktik.

## Finalitete të programit të Administrimit Publik

- **Finalitete epistemike:** Pajisja e të diplomuarve me njohuri bazë mbi teorinë, vlerat, procedurat e institucioneve publike në nivel sektorial, lokal, qendror dhe komunitar.

Njohja e aspekteve të së drejtës administrative, financiare, të të drejtës së mjedisit, të drejtës së punës dhe sigurisë sociale, mënyrës së funksionimit të institucioneve shtetërore. Asimilimi i një pakete njohurish me institucionet, strukturat, mekanizmat, legjislacionin dhe funksionimin e sistemit publik evropian.

- **Finalitete profesionale:** Pajisja e të diplomuarve të ciklit të dytë me aftësi teorike dhe praktike ekzekutive për analiza sistemike, vlerësim performance, kërkim shkencor të aplikuar (sasior dhe cilësor) përfshi këtu dhe kërkimin shkencor të krahasuar, nën raportin e standarteve dhe rregullave të testimit empirik të profilit. Zotërimi i strukturave konceptuale specifike fushës së kompetencës.
- **Finalitete etiko-morale:** Të diplomuarit e këtij cikli do pajisen me një sërë parimesh dhe vlerash referenciale që mbështeten në normat ndërkombëtare të respektimit të kodeve deontologjike; të trajtimit me dashuri dhe respekt të të gjithë qytetarëve indiferent përkatësisë së tyre sociale, fetare, gjinore, krahinore etj.; baraslargësi nga grupet e presionit dhe interesave dhe implikim në proceset e vendimmarrjes duke respektuar interesat e përgjithshme të shoqërisë; politika të promovimit në sferën publike të bazuar në parimin e shanseve të barabarta, të meritokracisë, larg nepotizmit, politizimit apo korrupsionit. Stimulimi i respektimit të vlerave demokratike dhe një kërkim shkencor objektiv, jodiskriminues ndaj objektit në vëzhgim.
- **Finalitete psikologjike:** Formimi i një qëndrimi apolitik dhe barazlartues përkundrejt influencave ideologjike; Stimulimi i karrierës personale dhe injektimi i krenarisë për veten dhe dëshirën për sukses dhe vetafirmim; Stimulimi i një qëndrimi të hapur ndaj personave që u përkasin kombësive, etnive, besimeve fetare dhe gjithçkaje të ndryshme nga grupi i tij social. Stimulimi i aftësive komunikuese, mirëkuptuese dhe bashkëpunuese për përmirësimin e imazhit të funksionarit dhe institucioneve publike dhe atyre kombëtare.

## **Oportunitete punësimi dhe karriere**

- Të diplomuarit në pragramet master dhe diploma të nivelit të dytë në Administrim Publik do pajisen me një paketë konceptesh teorike dhe cilësish ekzekutive të aftë të shërbejnë në të gjitha nivelet e administratës publike qëndrore: presidencë, parlament, kryeministri, ministri, prefektura, institucione të tjera publike, sikurse mund të ndërmarrin iniciativa për krijimin e sipërmarrjeve private që afrojnë bashkëpunim dhe shërbime specifike për administratën publike qëndrore dhe atë vendore.
- Specialistët e formuar nga Universiteti ynë do jenë të aftë të drejtojnë punët publike në të gjitha dimensionet e hapsirës publike por në mënyrë të veçantë në nivel qarqesh, bashkish dhe komunash. Paketat formuese në hapsirën publike evropiane do mundësojnë kontributet në drejtimin e administratës publike shqiptare, në mënyrë të veçantë në institucionet publike integruese apo drejtoritë e veçanta të integritit evropian brenda ministrive, bashkive dhe prefekturave.
- Kategoria e të diplomuarve më të mirë do përbëjnë bazën e studjuesve, pedagogëve dhe analistë të shkencave administrative, pushtetit ekzekutiv, qeverisjes lokale, politikave publike në universitetet brenda dhe jashtë vëndit.

## **MASTER NIVELI I PARË**

### **“Qeverisje dhe Administrim Publik”**

**Kohëzgjatja: 1 vit /60 kredite**  
(me frekuentim mbasdite ose në fundjavë)

**Semestri I**

1. Etika në Administratë Publike
2. Komunikim dhe marrëdhënie me publikun
3. E drejtë dhe procedurë administrative
4. Financa publike, buxhet, fiskalitet
5. E drejta e mjedisit dhe zhvillim i qëndrueshëm

**Semestri II**

1. Administrim Publik
2. Statusi i funksionarit publik
3. Politika publike / Qeverisje lokale / Institucione dhe e drejtë europiane
4. Informatikë për administratë publike
5. Praktikë specialiteti
6. Punimi i Diplomës

**MASTER NIVELI I DYTË**  
**“Shkenca Administrative”**

**Kohëzgjatja: 1 vit /60 kredite**  
(me frekuentim mbasdite ose në fundjavë)

**Semestri I**

1. E drejtë kushtetuese e krahasuar
2. Teknologjia e Informacionit
3. E drejtë administrative
4. Financa publike
5. E drejta e mjedisit

**Semestri II**

1. Shkenca Administratës
2. Politika Publike/Qeverisje lokale
3. Institucione dhe e drejtë europiane
4. Strukturë, mekanizma dhe institucione administrative
5. Praktikë specialiteti
6. Punimi i Diplomës

**MASTER NIVELI I DYTË**  
**“Pushtet Ekzekutiv”**

**Kohëzgjatja: 1 vit /60 kredite**  
(me frekuentim mbasdite ose në fundjavë)

### **Semestri I**

1. E drejtë kushtetuese e krahasuar
2. Komunikim publik dhe marketing institucional
3. E drejtë dhe procedurë administrative
4. Financa publike dhe buxhet
5. E drejta e mjedisit dhe zhvillim i qëndrueshëm

### **Semestri II**

1. Pushtet ekzekutiv dhe Politika Publike
2. Procedurë Parlamentare
3. Institucione Politike
4. Teknologjia e Informacionit në Administratën Shtetërore
5. Praktikë specialiteti
6. Punimi i Diplomës

## **MASTER NIVELI I DYTË**

### **“Qeverisje vendore”**

**Kohëzgjatja: 1 vit /60 kredite**

(me frekuentim mbasdite ose në fundjavë)

### **Semestri I**

1. E drejta e mjedisit dhe zhvillim i qëndrueshëm
2. Komunikim publik dhe marketing institucional
3. E drejtë administrative
4. E drejtë financiare
5. E drejta e punës dhe sigurisë sociale

### **Semestri II**

1. Qeverisje lokale
2. Strategji të zhvillimit ekonomik lokal
3. Politika, planifikim dhe zhvillim urban
4. Teknologjia e informacionit
5. Praktikë specialiteti
6. Punimi i Diplomës

## **PRANIMI 2008 MASTER NË ADMINISTRIM PUBLIK**

### **Dosje e konkursit:**

- Kërkesë pranimi – formular tip (4 fotografi me ngjyra tip pashaporte)
- Çertifikatë lindje (Çertifikatë martese nëse është ndërruar mbiemri)
- Diplomë universitare (kopje e legalizuar)
- Vërtetim i vëndit të punës
- Vërtetim mjeksor
- Curriculum Vitae

### **Konkurimi:**

- Vlerësim i dosjes personale të kandidatit nga Komisioni i posaçëm i ngritur nga Departamenti i Shkencave Politiko- Administrative.

**Pagesat:**

- Taksë shkollore vjetore: 700 euro
- 
- 

**Të dhëna të plota mund të merren tek Fakulteti i Shkencave Shoqwrore, U.F.O University**

Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative

Bulevardi Zog i Parë (Mbas Muzeut Kombëtar, Godina e Ish-Estradës).

Te l. 042 2 22 71 601

Fax. 042 2 22 66 374

Web site – [www.ufouniversity.al](http://www.ufouniversity.al)

---

---

**Periudha e pranimit**

- Aplikimi & Regjistrimi 17 nëntor – 15 dhjetor 2008
- 

**STUDIME TË CIKLIT TË DYTË**

**“Administrim publik dhe pushtet ekzekutiv”**

**Kohëzgjatja: 2 vjet** (me frekuentim mbasdite dhe në fundjavë)

**Viti I**

1. E drejtë kushtetuese
2. Komunikim publik dhe marketing institucional
3. Institucione dhe e drejtë administrative
4. Institucione dhe e drejtë financiare
5. Proçedurë administrative
6. E drejta e punës dhe sigurisë sociale
7. Shkenca Administrative
8. Politikat e personelit dhe Menaxhimi i burimeve njerëzore
9. Etika dhe deontologjia e funksionarit publik
10. E drejta e mjedisit dhe zhvillim i qëndrueshëm

**Viti II**

1. Institucione Politike
2. Pushtet ekzekutiv dhe Politika Publike
3. Procedurë parlamentare
4. Teknologjia e informacionit
5. Institucione komunitare dhe integrim europian
6. Qeverisje dhe të drejtat e njeriut
7. Praktikë specialiteti
8. Punimi i Diplomës

## STUDIME TË CIKLIT TË DYTË

# “Administrim publik dhe Qeverisje vendore”

---

**Kohëzgjatja: 2 vjet** (me frekuentim mbasdite dhe në fundjavë)

### Viti I

1. Shkenca Administrative
2. Politikat e personelit dhe Menaxhimi i burimeve njerëzore
3. Etika dhe deontologjia e funksionarit publik
4. E drejta e mjedisit dhe zhvillim i qëndrueshëm
5. E drejtë kushtetuese
6. Komunikim publik dhe marketing institucional
7. Institucione dhe e drejtë administrative
8. Institucione dhe e drejtë financiare
9. Proçedurë administrative
10. E drejta e punës dhe sigurisë sociale

### Viti II

1. Administrata publike lokale
2. Politika publike lokale
3. Strategji të zhvillimit ekonomik lokal
4. Teknologjia e informacionit
5. Politika, planifikim dhe zhvillim urban
6. Politika antikorrupsion dhe antidiskriminim
7. Praktikë specialiteti
8. Punimi i Diplomës

---

## STUDIME TË CIKLIT TË DYTË

# “Administrim publik dhe Politika e Menaxhim Shëndetsor”

---

**Kohëzgjatja: 2 vjet** (me frekuentim mbasdite dhe në fundjavë)

### Viti I

1. Proçedurë administrative
2. E drejta e punës dhe sigurisë sociale
3. Shkenca Administrative
4. Politikat e personelit dhe Menaxhimi i burimeve njerëzore
5. Etika dhe deontologjia e funksionarit publik
6. E drejta e mjedisit dhe zhvillim i qëndrueshëm
7. E drejtë kushtetuese

8. Komunikim publik dhe marketing institucional
9. Institucione dhe e drejtë administrative
10. Institucione dhe e drejtë financiare

## **Viti II**

1. Menaxhimi i shërbimeve shëndetsore
2. Shëndeti Publik
3. Politika Publike të Shëndetësisë
4. Ekonomi Sanitare
5. Legjislacion Sanitar
6. Komunikim dhe Marketing Mjekësor
7. Praktikë specialiteti
8. Punimi i Diplomës

---

## **STUDIME TË CIKLIT TË DYTË**

# **“Administrim publik dhe Hapësira Publike Europiane”**

**Kohëzgjatja: 2 vjet** (me frekuentim mbasdite dhe në fundjavë)

## **Viti I**

1. E drejtë kushtetuese
2. Komunikim publik dhe marketing institucional
3. Institucione dhe e drejtë administrative
4. Institucione dhe e drejtë financiare
5. Proçedurë administrative
6. E drejta e punës dhe sigurisë sociale
7. Shkenca Administrative
8. Politikat e personelit dhe Menaxhimi i burimeve njerëzore
9. Etika dhe deontologjia e funksionarit publik
10. E drejta e mjedisit dhe zhvillim i qëndrueshëm

## **Viti II**

1. Struktura, mekanizma dhe institucione të BE
2. Ekonomi Europiane
3. Politika rajonale të Bashkimit European
4. Politika europiane të sigurisë dhe mbrojtjes
5. E Drejtë dhe acquis komunitar
6. Funksioni publik dhe menaxhim publik european
7. E drejtë dhe Siguri Sociale Europiane
8. Praktikë specialiteti
9. Punimi i Diplomës

# **PRANIMI 2008 DIPLOMA TË NIVELIT TË DYTË NË ADMINISTRIM PUBLIK**

## **Dosje e konkursit:**

- Kërkesë pranimi – formular tip (4 fotografi me ngjyra tip pashaporte)
- Çertifikatë lindje (Çertifikatë martesë nëse është ndërruar mbiemri)
- Diplomë universitare e Nivelit të Parë 3 vjecare (kopje e legalizuar), në përputhje me udhëzimet e MASH
- Vërtetim i vëndit të punës
- Vërtetim mjeksor
- Curriculum Vitae

## **Konkurimi:**

- Vlerësim i dosjes personale të kandidatit nga Komisioni i posaçëm i ngritur nga Departamenti i Shkencave Politiko- Administrative.

## **Pagesat:**

- Taksë shkollore vjetore: 1500 euro/viti
- 

**Të dhëna të plota mund të merren tek Fakulteti i Shkencave Shoqërore, U.F.O  
University**

Departamenti i Shkencave Politiko-Administrative

Bulevardi Zog i Parë (Mbas Muzeut Kombëtar, Godina e Ish-Estradës).

Te l. 042 2 22 71 601

Fax. 042 2 22 66 374

Web site – [www.ufouniversity.al](http://www.ufouniversity.al)

## **Periudha e pranimit**

- Aplikimi & Regjistrimi 17 nëntor – 15 dhjetor 2008
- 

# **OFERTA EDUKACIONALE NË MARËDHËNIE NDËRKOMBËTARE**

## **Misioni, objektivat e formimit dhe koncepti organizues**

- Modernizimi i strukturave publike të marëdhënies me jashtë nëpërmjet formimit bashkëkohor të funksionarëve publikë.

- Programi eliminon përgatitjen e specialistëve me kompetencë të kufizuar, zgjeron hapsirën e specializimit, tejkalon kufijtë tradicionalë midis shkencave duke afruar një trajtim ndërdisiplinor dhe multishkencor: Marëdhënie Ndërkombëtare, Diplomaci, Sociologji, Antropologji, Shkenca Komunikimi, Histori, Shkenca Administrative, Ekonomike, Siguri Kombëtare dhe Ndërkombëtare, Studime Europiane dhe Ballkanike etj.
- Programet: Master i Nivelit të Parë, Diploma të Nivelit të Dytë dhe Master Niveli i Dytë në Marëdhënie Ndërkombëtare ju adresohen të diplomuarve të Arsimit të Lartë (duke respektuar udhëzimet e MASH) të interesuar të thellojnë formimin apo konvertimin profesional në marëdhënie ndërkombëtare, sisteme qeverisëse, politikë e jashtme dhe diplomaci, politika të sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare, zhvillim institucional, integrim europian etj.
- Koncepti i organizimit: strukturë me sistem modular:
  - ✚ prezantimi dhe asimilimi i koncepteve fundamentale për sferën shkencore dhe akademike të marëdhënieve ndërkombëtare dhe diplomacisë;
  - ✚ përshkrimi i temave/subjekteve kryesore të specialitetit;
  - ✚ ofrimi i paketave opsionale, superspecializuese;
  - ✚ zhvillimi i kapaciteteve/aftësive të studentëve, për të përdorur instrumentet dhe potencialin intelektual të përfutur në analiza personale dhe kolektive mbi fenomenin e politikës së jashtme, proceset diplomatike, integruese europiane, në plan teorik dhe praktik.

## **Finalitete të programit në Marëdhënie Ndërkombëtare**

- **Finalitete epistemike:** Pajisja e të diplomuarve të ciklit të dytë në Marëdhënie Ndërkombëtare me njohuri bazë mbi teoritë e marëdhënieve ndërkombëtare, procedurat, politikat, institucionet dhe të drejtën publike ndërkombëtare. Një vëmendje e veçantë ju kushtohet dimensionit dhe njohjes së strukturave, institucioneve, legjislacionit dhe funksionimit të institucioneve europiane. Sistemi i vlerave dhe parimeve referuese në mbrojtjen ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe mjedisit rrethues, janë aspekte të tjera që plotësojnë paketën e njohurive themelore të marëdhënieve ndërkombëtare. Paketat opsionale thellojnë njohuritë në disa profile: *Integrimi europian* përqëndrohet tek politikat sektoriale, rajonale, të sigurisë dhe mbrojtjes europiane, së bashku me dimensionin ekonomik dhe institucional komunitar; globalizimi, gjeopolitika, analizat e politikës së jashtme, teoria dhe praktikat diplomatike apo diplomacia publike janë pjesë formuese e dimensionit *politikë e jashtme dhe diplomaci*; njohuritë mbi sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare sikurse karakteristikat e Ballkanit (konflikte, minoritete, mite, kulturë, simbole) janë dy dimensione të tjera, pjesë e ciklit të dytë *marëdhënie ndërkombëtare*.
- **Finalitete profesionale:** Pajisja e të diplomuarve të ciklit të dytë me aftësi teorike mbi marëdhëniet ndërkombëtare, gjeopolitikën, gjeostrategjinë, si dhe stimulimi i aftësive praktike për analiza sistemike, kërkim shkencor në çështje ndërkombëtare përfshi këtu dhe kërkimin shkencor të krahasuar, nën raportin e standarteve dhe rregullave të testimit empirik të profilit. Të diplomuarit e këtij cikli pajisen me aftësi për konstruksione logjike me bazë teorike dhe empirike, kompetenca argumentuese dhe këshilluese për institucionet qeveritare që mbulojnë marëdhëniet ndërkombëtare dhe integrimin euroatlantik, institucionet ndërkombëtare, organizatat joqeveritare etj., të

